



№ Drita 05 - 07 - 2018

[Handwritten signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:006010
 Datë: 23.05.2018
 Numri i dokumentit: 00043665

P.nr.318/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENALE si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të pandehuri [REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED], Komuna e Vitisë, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Departmenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.513-5/18, e dates 26.02.2018, për shkak të veprës penale "sulum" nga neni 187 par.1 të KPRK-ës, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor - fillestar, në praninë e prokurorit të shtetit Bahri Hyseni, të pandehurit [REDACTED] të dëmtuarëve [REDACTED] dhe [REDACTED] me datën 23.05.2018, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri [REDACTED], me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna e Vitisë i lindur me datën [REDACTED], në Gjilan, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, punon privat, i gjendjes së mesme ekonomike i pa dënuar deri me tani mbrohet në liri me numër personal të letërnjoftimit [REDACTED], -

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 07.03.2017, rreth orës 19:35 h, në rrugën "Ahmet Kaçiku" në Ferizaj, përkatësishtë në Stacionin e autobusëve, i pandehuri [REDACTED], i ka sulmuar fizikisht të dëmtuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] pas një mosmarrëveshje ku të dëmtuarit nuk kanë pësuar lëndime trupore,-

- me këtë ka kryer veprën penale "sulum" nga neni 187 par.1 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarin e

G J Y K O N M E D Ë N I M M E G J O B Ë

I. Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 150 / njëqind e pesëdhjetë / Eurosh, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në tri këste mujore në afat prej tre muajsh, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj dhe [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike nuk janë udhëzuar pasi kanë hequr dorë në shqyrtimin fillestar.

III. Obligohet i pandehuri të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) Euro, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbaramit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.513-5/18, e datës 26.02.2018, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR], Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale "sulm" nga neni 187 par.1 të KPRK-ës.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt. 23.05.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurorit të shtetit Bahri Hyseni, të pandehurit [REDAKTUAR] të dëmtuarëve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari pyet të pandehurin se a ka pranuar me ftesë edhe aktakuzën por deklaroi jo të njëjtit i jep një kopje dhe kohë për leximin e saj.

Në shqyrtimin fillestar i pandehuri është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të pandehurit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të pandehurit, ku gjyqtari gjykues është bindur se i pandehuri pas leximit të aktakuzës e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I pandehuri [REDAKTUAR], ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën më ngarkon aktakuza dhe të dëmtuarave i kërkon falje dhe është penduar për veprën penale që e ka kryer, por tani me të dëmtuarit nuk ka kurrfarë mosmarrëveshje të keqe dhe i propozon gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr për bazë pranimin e fajësisë dhe ka premtuar se më nuk do të përsërisë veprime të tilla në të ardhmen.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së,

është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Bahri Hyseni, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi pranimi i tillë është bërë konform ligjit gjegjësisht në bazë të nenit 248 të KPPRK-së, dhe ka mbështetje edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të cilat e vërtetojnë gjendjen faktike.

I dëmtuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk ka parashtron kërkesë pasurore-juridike, pra ka hequr dorë.

I dëmtuari [REDAKTUAR] shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk ka parashtron kërkesë pasurore-juridike, pra ka hequr dorë.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në deklaratën e të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhënë në polici me datën 10.03.2017, të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhënë në polici me datën 09.03.2017 dhe të pandehurit me datën 09.03.2017, dhe në shkresat tjera që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale "sulum" nga neni 187 par.1 të KPRK-ës.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit, pendimin për veprën penale të kryer, kërkim falje të dëmtuarave, të dëmtuarit nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe nuk kanë parashtruar kërkesë pasurore-juridike, hera parë që ndeshet me ligjin, gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkëimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata konformë nenit 461 parag.1 të KPPK-së të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj dhe [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, nuk e ka udhëzuar në kontest civil pasi në shqyrtimin fillestar kanë hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesë pasurore juridike.


Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit Nr.05/L-036

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.318/18 me datë 23.05.2018

Zyrtare Ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.